REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

20-vjet nga sulmet e 11 shtatorit, Xhaçka: Më të bashkuar kundër terrorizmit dhe ekstremizmit
2021-09-13 11:03:00

Ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka, ka përkujtuar 20-vjetorin e sulmeve të 11 shtatorit, si pasojë e të cilit rreth 3 mijë persona humbën jetën në SHBA. Nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, Ministrja Xhaçka u shpreh se 11 shtatori është një ditë për të përkujtuar e nderuar kujtimin e atyre mijëra jetëve të pafajshme të humbura atë ditë.
"Sulmet e 11 shtatorit 2001 janë një nga ato ngjarje që vështirë do të shlyhen ndonjëherë nga kujtesa. Por mbi të gjitha, 11 shtatori është një ditë për të përkujtuar e nderuar kujtimin e atyre mijëra jetëve të pafajshme të humbura atë ditë e për të qenë më të bashkuar se kurrë edhe në emer të tyre, kundër terrorizmit e ekstremizmit", shkruan ministrja në Facebook.